



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 10 shkurt 2015
Nr. ref.:RK770/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI161/14

Parashtrues

Mursel Izeti

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml.
nr. 99/2014, të 10 qershorit 2014**

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Mursel Izeti (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), nga fshati Greme, komuna e Ferizajt, i përfaqësuar nga z. Besnik Berisha, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Pml. nr. 99/2014, i 10 qershorit 2014, me të cilin është refuzuar, si e pabazuar kërkesa e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë. Ky vendim i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 25 qershor 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohen të jenë shkelur neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe neni 6 [E drejta për një proces të rregullt] i Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), sepse *“Gjykatat pa ndonjë arsyetim të qëndrueshëm nuk i kanë shqyrtuar provat e propozuara nga Mbrojtja. Provat e pa administruara nga kjo Gjykatë janë shumë relevante dhe me ndikim për vërtetimin e fajësisë apo pafajësisë së parashtruesit të kërkesës”*.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 (b) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 27 tetor 2014, parashtruesi dorëzoi me postë kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), dhe ajo arriti në Gjykatë, më 29 tetor 2014.
6. Më 6 nëntor 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin GJR. KI161/14, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës me Vendimin KSH. KI161/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
7. Më 6 nëntor 2014, Gjykata e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai dorëzimin e autorizimit për përfaqësim për z. Besnik Berishën.
8. Më 19 nëntor 2014, parashtruesi dorëzoi dokumentacionin e kërkuar nga Gjykata.
9. Më 24 nëntor 2014, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme dhe Gjykatën Themelore në Ferizaj - Departamentin për krime të rënda (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) për regjistrimin e kërkesës si dhe kërkoi nga kjo e fundit dorëzimin

e fletëkthesës, që dëshmon datën kur parashtruesi ka pranuar Aktgjykimin (Pml. nr. 99/2014, të 10 qershorit 2014) të Gjykatës Supreme.

10. Më 4 dhjetor 2014, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën, e cila tregon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, i 10 qershorit 2014, i është dorëzuar avokatit të parashtruesit, më 25 qershor 2014.
11. Më 22 janar 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 22 mars 2013, Gjykata Themelore në Ferizaj - Departamenti për krime të rënda (Aktgjykimi PKR. nr. 9/2013-P. 94/12 PR1), shpalli fajtor parashtruesin për kryerjen e veprës penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe e dënoi atë me burgim. Parashtruesi kishte pranuar fajësinë në fillim të seancës për veprën penale të “mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve” siç parashihet me nenin 328, paragrafi 2, i Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPK), por jo edhe për veprën penale “vrasje e rëndë” siç parashihet me nenin 147, paragrafi 1, nënparagrafi 9 i KPK-së, sepse veprimet e tij janë kryer në vetëmbrojtje. Gjykata Themelore bazoi gjetjet e saj në provat vijuese:
 - a. pjesërisht nga mbrojtja e vet të akuzuarve gjatë shqyrtimit gjyqësor, dhe gjatë procedurës hetimore;
 - b. nga dëshmitë e dëshmitarëve;
 - c. nga shikimi në fotoalbum, skicë dhe fotografi në vendngjarje;
 - ç. nga leximi i raportit të autopsisë së Departamentit të Mjekësisë Ligjore nr. NA11-033;
 - d. nga leximi i raportit të ekspertizës për armën e zjarrit;
 - dh. nga leximi i raportit të ekspertizës daktiloskopike.
13. Parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimin të Gjykatës Themelore për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës penale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal. Parashtruesi i kërkesës pretendoi se Gjykata Themelore ia kishte mohuar atij mundësinë për t'i bërë pyetje ekspertit, që do të kishte kontribuar në gjetjen e së vërtetës së çështjes përmes pyetjeve.
14. Më 12 nëntor 2013, Gjykata Apelit (Aktgjykimi PAKR. nr. 303/2013) refuzoi ankesën dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit vlerësoi se parashtruesit të kërkesës nuk i ishte mohuar asnjë e drejtë e garantuar me Kodin Penal të Kosovës, që mund të vërtetohet nga shkresat e lëndës, veçanërisht me procesverbalin e shqyrtimit kryesor.
15. Parashtruesi parashtrroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimin të Gjykatës Themelore dhe kundër Aktgjykimin të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e shkallëve të ulëta nuk kishin ofruar arsye për mosaprovimin e propozimit të

parashtruesit të kërkesës për dëgjimin e ekspertit mjekoligjor, për të bërë rikonstruimin e vendit të ngjarjes dhe për dëgjimin e ekspertit balistik.

16. Më 10 qershor 2012, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Pml. nr. 99/2014) refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës. Gjykata Supreme konsideroi se ankesa e parashtruesit nuk përmbante ndonjë specifikim në lidhje me mënyrën se si shkeljet e pretenduara ishin manifestuar në vendimet e shkallëve më të ulëta.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon “[...] në procedurën kundër tij u cenua Parimi i barazisë së armëve dhe se ky veprim u manifestua me refuzimin e propozimeve të Mbrojtjes së parashtruesit, për të marrë prova dhe dëgjuar dëshmitar në interes të Mbrojtjes, ndërsa në anën tjetër Prokurorisë iu mundësua dëgjimi i të gjithë dëshmitarëve dhe dorëzimi i provave edhe në shqyrtimin kryesor [...]”.

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata vëren se, për të qenë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit së pari duhet të shqyrtojë nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

19. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

20. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullat 36 (1) d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës, të cilat parashohin:

“Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

- (a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose*
- (b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose*
- (c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë; ose*
- (ç) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

21. Gjykata vëren se në rastin konkret parashtruesi i kërkesës ankohet se gjykatat e rregullta kishin hedhur poshtë propozimin e tij për të dëgjuar ekspertin mjekoligjor dhe ekspertin balistik dhe për të bërë rikonstruimin e vendit të ngjarjes, pa dhënë ndonjë arsye të vetme për refuzimin.
22. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se Gjykata Themelore në Ferizaj ka dhënë arsye të gjera për gjetjet e saj, dhe gjithashtu i është referuar praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe dispozitave të Kushtetutës në lidhje me supozimin e pafajësisë. Për më tepër, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kanë arsyetuar vendimet e tyre dhe kanë argumentuar secilin nga pretendimet e parashtruesit në lidhje me refuzimin e propozimit të tij.
23. Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj konstatoi që parashtruesi ka pasur mundësi të shumta për të mbrojtur veten e tij dhe se atij i është dhënë mundësia për të parë shkresat e lëndës. Përveç kësaj, ajo konstatoi se nuk është e mjaftueshme të thuhet, për shembull, se aktgjykimi nuk është i bazuar në përmbajtjen e shkresave të lëndës, ose se ai është i bazuar në supozime, por duhet të shpjegohet ku është kundërthënia dhe cilat janë të metat në arsyetimin e fakteve vendimtare. Për shkak të mungesës të saktësimin në dhënien e këtyre shpjegimeve, Gjykata Supreme vlerësoi se pretendimet në fjalë ishin të pabazuara. Gjykata Supreme, në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se Gjykata Themelore nuk e ka arsyetuar refuzimin e propozimit të parashtruesit të kërkesës në lidhje me administrimin e provave, ka gjetur se në faqen 11 (njëmbëdhjetë) të aktgjyimit është shpjeguar pse kërkesa e parashtruesit ishte refuzuar. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës ka komentuar edhe shkresat e lëndës.
24. Gjykata rithekson që nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. Detyra e Gjykatës është që të shqyrtojë nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, duke përfshirë mënyrën se si janë marrë provat, kanë qenë të drejta (Shih, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut e miratuar me 10 korrik 1991).
25. Në rastin konkret, Gjykata nuk gjen se procedurat përkatëse në Gjykatën Supreme kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kunder Lituanisë*, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).
26. Prandaj, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar pretendimet e tij në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar dëshmi, për të treguar si dhe pse të drejtat dhe liritë e tij, të mbrojtura me Kushtetutë, janë shkelur me vendimin e kontestuar.
27. Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës, më 10 shkurt 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Arta Rama-Hajrizi



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani